

UDHËZIM
Nr. 6, datë 9.1.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS DHE AFATEVE TË PAGESËS SË DETYRIMEVE
LIGJORE TË SHOQËRIVE TË LICENCUARA NË FUSHËN E LOJËRAVE TË FATIT
PËR LLOGARI TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES SË LOJËRAVE TË FATIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 155/2015, datë 21.12.2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Ky udhëzim ka si qëllim përcaktimin e mënyrës dhe afateve të pagesës së detyrimeve ligjore të shoqërive të licencuara në fushën e lojërave të fatit për llogari të Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

2. Shoqëritë e licencuara në fushën e lojërave të fatit shlyejnë detyrimin e ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit në përputhje me masën e parashikuara në ligjin nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”.

3. Periudha e detyrimit vjetor fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Në rast se veprimtaria në fushën e lojërave të fatit krijohet ose pushon brenda kësaj periudhe, detyrimi i shoqërive llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e ushtrimit të veprimtarisë për të cilën shoqëria është licencuar.

4. AMLF-ja hap llogari në një bankë të nivelit të dytë ku do të depozitohen të ardhurat nga pagesat që bëjnë shoqëritë e licencuara në fushën e lojërave të fatit, sipas nenit 14, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”.

5. Kur afati i fundit për pagesën e detyrimit sipas këtij udhëzimi bie në ditë pushimi, data e pagesës së detyrimit është dita e parë e punës, pas ditës së pushimit.

6. Mbas shlyerjes së çdo kësti të pagesës, shoqëritë e licencuara për lojëra fati duhet të depozitojnë një kopje të mandate-pagesës /dokumentit vërtetues pranë AMLF-së.

7. Shoqëritë e licencuara në fushën e lojërave të fatit detyrohen që, brenda datës 5 prill të çdo viti, ose në momentin e mbylljes së aktivitetit, kur ai mbyllet gjatë vitit ushtrimor, të depozitojnë pranë AMLF-së një kopje të bilancit dhe të pasqyrave financiare të njehsuara nga organet tatimore të shoqëruara me të gjitha mandat pagesat e kryera sipas këtij udhëzimi, gjatë vitit përkatës.

8. Bilanci kontabël së bashku me anekset e tij dorëzohen në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi.

9. Vetëm pas implementimit të Sistemit Qendror të Monitorimit On-line (SQMO) organizatorët e licencuara në fushën e lojërave të fatit derdhen në llogarinë bankare të Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit 3% të të ardhurave bruto nga loja por jo më pak se 1.500.000 lekë (1 milion e pesëqind mijë lek) në vit për secilin subjekt.

10. Shuma e detyrimit të secilës shoqëri të licencuar për lojëra fati derdhet në llogarinë e AMLF-së në përputhje me afatet e mëposhtme:

- a) për pjesën e mbetur të vitit 2016, pagesa do të bëhet, brenda datës 10 janar të vitit 2017.
- b) për vitin 2017 dhe vitet në vijim, pagesat do të bëhen me katër këste, si më poshtë vijon:
 - i) kësti i parë, do të paguhet brenda datës 10 prill;
 - ii) kësti i dytë, do të paguhet brenda datës 10 korrik;
 - iii) kësti i tretë do të paguhet brenda datës 10 tetor;
 - iv) kësti i katërt, do të paguhet brenda datës 10 janar (i vitit pasardhës).

11. Në rast se pagesa e kështit nuk kryhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 10 të këtij udhëzimi, AMLF-ja njofton subjektin për detyrimin e papaguar dhe penalitetet që aplikohen sipas ligjit nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” duke kërkuar njëkohësisht kryerjen e

menjëhershme të pagesës.

12. Të ardhurat e siguruara nga pagesat që bëjnë organizatorët e lojërave të fatit përdoren për financimin e veprimtarisë së AMLF-së në përputhje me parashikimet e nenit 12, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”.

13. Ngarkohet Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe Shoqëritë e licencuara në këtë fushë për zbatimin e këtij udhëzimi.

14. Udhëzimi nr. 47, datë 26.11.2009, “Për mënyrën dhe afatet e kryerjes së pagesës së detyrimeve ligjore të subjekteve të miratuara dhe të licencuara në fushën e lojërave të fatit”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj